



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: OMK) në vazhdim të aktivitetëve të saj, duke u bazuar në dispozitat e Rregullores për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional në lidhje me përkrahjen e zhvillimit të kapaciteteve njerëzore shkencore të vendit dhe me qëllim të promovimit të shkencës kosovare shpallë:

**KONKURS**  
**(PËR PËRKRAHJE FINANCIARE TË PUNIMEVE SHKENCORE PËR VITIN 2022)**

Oda e Mjekëve të Kosovës i bënë thirrje mjekëve Kosovarë të konkurojnë për përfitimin e granteve shkencore për punimet e publikuara përgjatë vitit 2022. Dhjetë (10) punimet e përzgjedhura sipas kriterëve të poshtëshënuara do të përfitojnë shumën në vlerë prej 1.000 € (euro).

**Kushtet dhe procedurat**

**Kriteret obligative të pranimit janë:**

- Mjeku duhet të jetë anëtar i Odës së Mjekëve të Kosovës;
- Mjeku duhet të jetë autor i parë i punimit shkencor;
- Periudha kohore e publikimit të punimit duhet të jetë përgjatë vitit 2022

**Kriteret selektive të pranimit llogariten me sa vijon:**

1. Origjina e punimit:
  - a. Kosovë vlerësohet me **4 pikë**
  - b. Jashtë Kosovës vlerësohet me **2 pikë**
2. Lloji i punimit:
  - a. Research Article, Original Article, Review, Meta-analysis vlerësohen me **8 pikë**
  - b. Case report vlerësohet me **4 pikë**
  - c. Tjera (*correspondence, letter to the editor, short communication*) vlerësohen me **2 pikë**
3. Impakt faktori

**Mënyra e vlerësimit:** Totali i pikëve do të llogaritet **përmes shumëzimit** të vlerave numerike të kritereve obligative dhe selektive të lartpërmendura (\*).

*\*Nëse vlera numerike e kritereve obligative është 0 (zero), atëherë numri total i pikëve do të rezultojë me vlerë zero dhe kandidati do të eliminohet nga konkurimi.*

***Koment shtesë:***

Nëse në fund të listës së kandidatëve të përzgjedhur rezulton më tepër se një kandidat me pikë të njejta, atëherë shuma e dedikuar ndahet në përpjestim të barabartë me numrin e kandidatëve.

-Një kandidat ka të drejtë aplikimi me vetëm një punim.

Për të aplikuar, të interesuarit duhet të dërgojnë:

(I). Formularin për aplikim (e gjeni të bashkangjitur) dhe

(II). Punimin me të cilin aplikoni.

Dokumentet mund të dërgohen përmes email adresës zyrtare të Odës: [info@omk-rks.org](mailto:info@omk-rks.org) duke shënuar në subjekt (subject) që jeni duke i'u përgjigjur konkursit publik për përkrahje financiare të punimit shkencor. Të njejtat mund t'i dorëzoni në kopje fizike pranë zyreve të OMK-së, QKUK, Insitutet A, Kati III, 10 000, Prishtinë.

Afati për konkurim është i hapur nga data: 03 mars 2023 deri 17 mars 2023 në ora 16:00.

*Për sqarime dhe pyetje në lidhje me konkurimin ju lutemi drejtoheni pranë zyrës ligjore të OMK-së: [liridon.beba@omk-rks.org](mailto:liridon.beba@omk-rks.org) dhe asistentit [merjime.krasniqi@omk-rks.org](mailto:merjime.krasniqi@omk-rks.org) apo kontaktoni në numrin e telefonit 049-872-070.*